

Sprovë për një lexim kritik të materialit gjuhësor në veprën e Angelo Masci-t

“...e se alcuno quasi di passaggio ne ha fatto parola, ha piuttosto con errori la verità ingombra. ...”

(A. Masci, *Discorso...*, 1807, f. 2)

I. Problematika dhe diskutimi përkatës

Mbledhja dhe përpunimi i leksikut historik e bashkëkohor arbëresh përbëjnë njëren ndër ndërmarrjet madhore të qëndrave albanologjike në universitetet e Kalbrisë dhe të Palermos. Ngërthimin e tij në paletën e programit për botimin dhe ribotimin e gjithë trashëgimisë letrare arbëreshe në dorëshkrim e motivon sigurisht – duke u lejuar të citoj këtu albanologun e njohur arbëresh Antonino Guzzetta – “...la singolare coincidenza e comunanza di obbiettivi fra le diverse discipline albanologiche, in particolare fra storia e storiografia letterarie, fra filologia e critica letteraria, fra critica testuale e analisi linguistica...”¹. Sigurisht që studime ndërdisiplinore të kësaj natyre nuk mund të mos ndikojnë pozitivisht edhe në mbledhjen e (ri)vlerësimin kritik të materialit gjuhësor që trashëgojmë prej letërsisë albanologjike kryesisht në periudhat e mëhershme të lëvrimit të saj. Duke rishtruar këtu për diskutim leximin kritik-filologik të materialit gjuhësor në veprën e eruditit arbëresh Angelo Masci: *Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della natione Albanese* (Napoli 1807)², vëmë njëherësh theksin mbi nevojën e gjithhershme për plotësimin e analeve të historisë së mendimit albanologjik: së pari, me të dhëna sa më të sakta të karakterit filologjik e bibliografik për atë trashëgimi filologjike që disponojmë; e së dyti, me shkallën e njohjes, që përshkon debatin albanologjik sidomos në fazat e para të dokumentimit të tij.

Lidhur me veprën e Masci-t, anën e parë të kësaj çështjeje e motivonte deri para do kohësh rrallësia e botimit origjinal dhe e ribotimeve italisht³, përkatësisht recepcioni i saj në rrethet shkencore evropiane kryesisht nëpërmjet ribotimit të saj kritik në frengjisht prej dijetarit danez Malte-Brun: *Essai sur l'origine, les Meures et l'Etat actuel de la Nation Albanaise; par M. Ange Masci. Traduit de l'Italien; communiqué par M. Sonnini*⁴. Mungesa deri sot e një vëzhgimi ballafaques të veprës origjinale me

¹ Në prezantimin e botimit: Nicolò Figlia: *Il Codice Chieutino* (botues M.Mandalà), Comune di Mezzoioso 1995, f. IX.

² Vendin dhe vitin e botimit të parë e mësojmë, ndër të tjera, nga fjala hyrëse e botuesit të botimit të tretë (1847), Francesco Masci. Shih edhe Dh. Shuteriqi: *Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850*, Prishtinë 1978², f. 160v.

³ Për ribotimet e tjera në italisht, shih J. Kastrati: *Historia e albanologjisë*, Tiranë 2000, f. 560.

⁴ Në serinë *Annales des Voyages de la géographie et de l'histoire; ou Collection des voyages nouveaux les plus estimés, traduites de toutes les langues européennes...; publiées par M. Malte-Brun*, Tome troisième, Comprenant les cahiers VII à IX , Paris 1808.

versionin e saj në frengjisht ka shmangur hetimin e ndonjë gabimi që është përfshuar gjatë përkthimit apo ribotimit kritik të veprës. Kjo situatë, siç do ta shqyrtojmë hollësishët më poshtë, nuk mund të mos nxiste si reaksion zinxhir syzime të diskutueshme lidhur me materialin leksikor, që Masci shqyrtzon në vepër, apo me sistemin grafik që ai përdor.

Çështje të kësaj natyre ngërthejnë në vjetvete edhe objektin e këtij punimi, ku synojmë të plotësojmë sadopak ndonjë boshllék a të mënjanojmë ndonjë pasaktësi e, në këtë mënyrë, të përforcojmë mendimin mbizotërues mbi vendin e Masci-t në historinë e albanologjisë. Pas një paraqitje të përbledhur të materialit leksikor që autorri sjell në vepër, do të ndalemi më gjërë në disa çështje të karakterit filologjik, që kanë të bëjnë me burimin dhe përpunimin diakronik të këtij materiali si nga Masci ashtu edhe nga redaktori i veprës së tij, Malte-Bruni-i. Në bashkëvajtje me funksionin e materialit lexikor në vepër jemi mjaftuar në disa raste vetëm me konstatimin apo paraqitjen e thukët të tezave që përsiasin njëri apo tjetri dijetar lidhur me ato çështje që ushqenin debatin intelektual të kohës, si p.sh.: origjina e shqiptarëve dhe e gjuhës së tyre, marrëdhëni e tyre të afërisë me një a me disa popuj të Ballkanit (para)antik, i ashtuquajturi atdhe i parë i shqiptarëve e ndonjë tjetër⁵.

II. Materiali leksikor në funksion të argumentit gjuhësor

1. ... në punimin origjinal

Materiali leksikor është në funksion të argumentetit gjuhësor, me të cilin Masci pjesëmerr në debatin intelektual të kohës lidhur me çështjet e orgjinës së shqiptarëve. Ky debat pasqyrohet në vepër në formë të detauar në kreun e parë (*Dell'Origine degli Albanesi*, f. 2 – 29). Në këtë krye:

- a) Autori përdor argumentin gjuhësor për të mbajtur qëndrim kritik ndaj tezës, sipas së cilës shqiptarët e viseve të Ballkanit janë pasardhësit e drejtëpërdrejtë të Albanëve të Kaukazit. Masci përballet që në fillim të punimit me këtë tezë. Ai, ndër të tjera, përgas 62 njësi leksikore të shqipes me gjegjëset e tyre në gjeorgjishtes për të treguar se sa të ndryshme janë këto gjuhë nga njëra-tjetra⁶.
- b) Masci mbron mendimin se shqipja në rrjedhë të kohës ka pësuar ndikime të fuqishme e të vazhdueshme kryesisht prej gjuhëve të popujve fqinjë, si p.sh.: latinishtja, gotishtja etj. Masci sjell madje në analizë 41 syresh, duke mëtuar originën e tyre të ashtuquajtur galike⁷. Këto dëshmi gjuhësore tumirin, sipas tij, tezën e përkundërt, sipas së cilës shqiptarët janë anas në trojet e tyre të Ballkanit perëndimor.

⁵ Një shtjellim i detauar i këtij aspekti shumë të rëndësishëm të veprimtarisë intelektuale të Masci-t do ta kapërcente objektin dhe qëllimin e këtij punimi.

⁶ Kundërshtimin e këtij mendimi në albanologji e ndeshim për herë të parë në një relacion të P. Mazrrekut, arqipeshk i Tivarit, drejtuar Kongregacionit Propaganda Fide më 1633; shih për këtë *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. 1 (1610 – 1634), Tiranë 1963, f. 449.

⁷ Konceptin e kontakteve gjuhësore si edhe të shtresave të huazimeve në gjuhën shqipe Masci i ka përvetësuar me sa duket prej Letrave të Shqiptarëve të Leibniz-it, të cilat i citon rregullisht në vepër (f. 24vv.); sidomos atë të W. v. Leibniz: *Opera Omnia*, Bl. V, 1768⁽¹⁾, f. 494: “.... J'y remarque cependant beaucoup de Latin.....” (Letra e tretë: Hannover, më 10 dhjetor 1709). Shih më hollësishët për vendin e Leibniz-it në albanologji, B.Demiraj: *Si ta lexojmë Latincin?*, në: SF 1-2 [2001] f.163vv.

- c) Masci përcakton gjithashtu hapësirën territoriale të etnosit shqiptar (ndërmjet Shkodrës dhe Gjirit të Artës). Me qenë se në antikitet në këtë hapësirë ballkanike jetonin disa popuj jogrekë, Masci sheston tezën e një trungu të përbashkët gjenealogjik midis ilirëve të vjetër, maqedonasve dhe epirotëve⁸. Këtë tezë e mbështet, sipas tij, edhe shpjegimi etimologjik me mjete të shqipes i një numri glosash a të dhënash të toponomastikës ilire, maqedone dhe epirote: maq. *Loon* “ecatombeon; Luglio” ~ shq. doonaar “korrik”; epir. (ofiq i Akilit) *Aspet(t)o* “veloce” ~ shq. *i shpejtë*; epir. (Top.) *Bora* ~ shq. *bor/ë,-a* “dëborë” (f. 22); ilir. (fisi) *Bullionı* ~ shq. (-arb.) «bugliaar “bujar” (f. 21).⁹
- d) Masci mund të konsiderohet me të drejtë si lexuesi i parë kritik i materialeve gjuhësore shqip, të botuara deri atë kohë. Duke marrë në analizë shembujt e sjellë në njëren ndër Letrat e Shqiptarëve të Leibniz-it, ai vëren aty shmangje në formën e gabimeve drejtshkrimore si edhe në shkrimin e fjalëve ndaras. Sipas tij: „..... Si noti però, che le sopra recate parole Albanesi sono malamente scritte. *Atti inn* [Leibniz: *Attiyne* – B.D.] (padre nostro) sono due parole, non una, e perciò non ha luogo il giudizio di Leibnitz di essere parola Scitica; *dee* (terra), non *seet*, e *na ndeyene* [Leibniz: *enandeyene* - B.D.] (e ci perdon) sono trè parole; *nde te kech* [Leibniz: *ndetekoch* – B.D.] (nel male) sono trè parole, poiche *te* è articolo...” (f. 23, shën. 1)¹⁰.
- e) Siç e përmendëm më lart, materiali gjuhësor shqip është përqëndruar në kreun e parë të punimit. Numrit të përgjithshëm të njësive leksikore që sillen në vështrim, i shtohen në krerët e tjerë të punimit vetëm dy njësi: «cette» “gjini; çetë, grup i armatosur” (f. 49vv) dhe masi “mëzi” (f. 79).

Nga një përllogaritje e thjeshtë e fjalëve shqip që citohen në vepër rezulton një sasi prej gjithë-gjithë 115 njësish leksikore¹¹. Korpusin kryesor e përbëjnë gjithsesi dy grupimet e para (II/1/a-b) që përfshijnë së bashku 102 njësi leksikore¹²

2. ... në ribotimin frengjisht të Malte-Brun-it

Ky numër prej 102 njësish leksikore është lidhur në historinë e albanologjisë më fort me emrin e Malte-Brun-it, redaktorit të ribotimit frengjisht të veprës. Një përqasje sado e përciptë me punimin original të shpie menjëherë në përfundimin, se kreu i parë i punimit original është ripunuar, përkatësisht ristrukturuar, madje tek-tuk deri në mosnjohje. Siç del edhe nga ndonjë shënim redaksional në vepër, këtë ndërhyrje redaktori i saj e motivon me përfshirjen e veprës në kuadrin e serisë “Annales de voyages...”, përkatësisht me interesat e rretheve të tjera intelektuale në Evropë¹³. Në

⁸ Për problemet e origjinës së popullit shqiptar si një ndër temat më të rrahura në debatin intelektual arbëresh të kohës, shih, ndër të tjerë, M. Mandalà: *L'opera di Nicolò Chetta e la cultura albanologica italo-albanese nel XVIII secolo*, në: *Dialecti italo-albanesi e letteratura*, Palermo 1992, f. 87vv.

⁹ Një tjetër shpjegim onomastik ndeshim në kreun IV (f. 79), ku autorit citon pasazhe nga *Disser-tazione Iistoria-cronologica del Regimento RealMazedone*, Bologna 1767, Bl. 19: “...Nicolaus Masius è Nauplio Peloponnesiaco vir egregie fortis, cui Polledro Epirotica lingua cognomen fuit.”

¹⁰ Shih shën. nr. 7.

¹¹ Shih më poshtë tabelën përbledhëse (V: Glosar)

¹² Fjala «cord “kordhë” është regjistruar në të dyja rubrikat.

¹³ “Nous supprimons l'inutile digression de M.Masci sur les Scythes, les Huns, les Turcs, les Goths, les Massagètes, les Slavons, les Sarmates, etc. M.Masci confond ensemble ces peuples de races diverces. Notre auteur, d'ailleurs très-érudit, n'est pas au fait des

përputhje me këto interesa argumenti gjuhësor e bashkë me të edhe aparati leksikor shqip ushtrojnë për Malte-Brun-in tjetër funksion:

- a) Ndryshe nga Masci, të cilit i intereson të zbulojë dhe të vërtetojë nëpërmjet argumentit gjuhësor (pranë atij etno-kulturor dhe sozial-antropologjik) origjinën dhe atdheun i parë të shqiptarëve, Malte-Brun-i synon që me anën e argumentit gjuhësor të zgjdhë çështje të farefisnisë së gjuhës shqipe me gjuhët fqinjë dhe me sosh evropiane. Në këtë kuadër duan vështruar një numër vërejtjesh redaksionale që Malte-Brun-i treshton në fund të kreut të parë (f. 165 – 170), ku, ndër të tjera, zëvendëson konceptin “huazim galik (=francez, anglez, gjerman)” të Masci-t me atë të “aférissé (=farefisnisé)”. Sipas tij: “Enfin, il n'est pas probable que des mots *anglais, français et allemands*, comme l'auteur s'exprime, aient été introduits dans l'albanais pendant le moyen âge. Ces mots semblent tenir à l'essence même de la langue albanaise; ils viennent des *racines* que cette langue (et probablement aussi la langue des anciens Illiriens) possédoit en commun avec les langues *celtiques* et *gothiques*. Il faut se borner à dire: l'albanais ressemble beaucoup aux langues les plus anciennes de l'europe, au grec, au celt, au gothique.” (f. 166v).

Këtë drejtim merr edhe shqyrtimi aparatit leksikor prej gjithsej 100 fjalësh shqipe në rubrikën “Vocabulaire albanais” (f. 167-170), ku Malte-Brun-i përsiat marrëdhëniet e mundshme etimologjike për 89 njësi¹⁴.

- b) Kjo hulli studimi e materialit leksikor vërehet edhe në shqyrtimin e etnonimit *Alban*, pranë emrit antik të qytetit *Albanopolis*. Masci-t i mjafton regjistrimi i bëre nga gjeografi aleksandrin Ptolemaios (shek. II e.j.) për të motivuar tezën mbi lashtësinë e shqiptarëve në trojet e sotme etnike. Për Malte-Brun-in “... la ressemblance des noms n'en est pas moins remarquable. Le mot *Alb*, *Alpe*, *Albain*, *Albion* signifie en celtique, en teutonique, et probablement aussi en ancien illyrien, *montagnes propres au pâturage*. Le nom des Albanais ne seroit-il donc pas synonyme à celui de *pasteurs montagnards?* ...” (f. 174-5)

III. Burimi dhe karakteri dialektor i korpusit leksikor

1. ...në analet e historiografisë albanologjike

Në analet e historisë së albanologjisë tumirej deri kohët e fundit mendimi, që korpusi leksikor kryesor prej 102 fjalësh shqipe (shih II/1/a-b) të ketë pasur zanafillën tek një studim etimologjik i filozofit dhe eruditit gjerman Leibniz, i cili u rimore më pas pa ndryshime nga Masci dhe u përmirësua me tej nga Malte-Brun-i¹⁵. Lidhur me

recherches historiques modernes; *Leibnitz* est encore son unique guide; les travaux d'un *Subm*, d'un *Flore*, d'un *Thunmann*, d'un *Pallas*, etc., paroissent lui être inconnus. Comme nous donnerons successivement dans les *Annales* les résultats de ces travaux, il nous est impossible d'y admettre des hypothèses surannées” (Malte-Brun, *vep. cit.*, f. 149)

¹⁴ Sa i përket disa paqartësive, të përhapura tashmë në albanologji lidhur me numrin e saktë të njësive leksikore që shqyrtohen në këtë rubrike, mund të përbledhim shkurtas se për ndonjë syresh mban përgjegjësinë vetë redaktori i veprës. Bëhet fjalë për gjithsej 100 njësi ndërkokë që në fund të listës lexojmë për “.... cent deux mots” (f. 170). Ndër këto 100 njësi 93 janë marrë nga dy grupimet kryesore të korpusit leksikor (II/1/a-b). Jashtë këtyre grupimeve qëndrojnë njësitet: *e*, *ndë*, *na*, *të*, *i keq* (II/1/d); *zetë* (II/1/e) dhe regjistrimi i gabuar *bostani* “jardin”. Shih më hollësisht tabelën përbledhëse (V/Glosar)

¹⁵ Shih ndër të tjerë J. R. v. Xylander: *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*, Frankfurt am Main 1835, f. 237; N.Jokl: *Grundriß der idg. Sprach- und Altertumskunde* 3.

karakterin dialektor të njësive leksikore në këtë korpus, ishte gjithashtu e qartë, se “Një pjesë e këtyre fjalëve janë të dalektit verior, gjë që tregon se autori [= Masci - B.D.] i ka nxjerë nga shkrimet e Leibnizit” (Shuteriqi *vep. cit.*, f. 161); ndërsa vetë “.... Leibnizi i ka marrë nga veprat e shkrimtarëve të letërsisë së vjetër shqipe të Veriut (Pjetër Budi, Frang Bardhi), si p.sh. **mbrâma** (= mbremja), **zjarm** (= zjarr), **âm** (= nënë), **ulk** (= ujk-u), **mot** (= kohë-a), **at** (= baba-i) etj.” “Pothuajse të gjithë emrat femërorë në trajtën e pashquar janë shkruar pa zanoren –ë fundore, e cila dëshmon se nuk dëgjohej në shekullin XVII, në të folmet e Veriut: **buk** (= bukë-a), **nat** (= natë-a), **bretkos** (= bretkocë-a), **pem** (= pemë-a)” (Kastrati *vep.cit.*, f. 550).

Pohimet e mësipërme dëshmojnë se klasifikimi i (një pjese të) njësive të korpusit leksikor si variante dialektore të gegërishtes bëhet, duke mbajtur parasysh:

- a) ndonjë trajtë leksikore arkaike, që del në letërsinë e vjetër të veriut: *ulk*
- b) bjerrjen e rregullt e zanores së patheksuar /-ə/ në pozicion fundor
- c) shkronjën â si paraqitje grafike e zanores hundore /ã/ të dialektit gegë, Në këto përfundime duhet të ketë ndikuar sidomos:
- d) literatura albanologjike (Pjetër Budi, Frang Bardhi) që shfrytëzon Leibniz-i në letrat e tij¹⁶.

2. ...në ribotimin kritik të veprës prej Malte-Brun-it

Ndjejkja e gjurmëve të këtyre pohimeve të çon deri te ribotimi frengjisht i veprës, ku hasim disa herë pohimin se ky korpus fjalësh “....renferme les mots albanais donnés par Leibnitz, et cités par M.Masci.” (f. 167). Ky konstatim fiksohet edhe në rubrikën “Vocabulaire Albanaïs” (f. 167-171), që përfshihet në shtojcën redaksionale të kreut të parë, përbajtjen e së cilës Malte-Brun-i e shtjellon më tej me nëntitullin “Tiré des Oeuvres de Leibnitz, et compare avec quelques autres Langues Européennes”. Nëse kemi të bëjmë këtu me një gabim përkthimi (prej Sonnini-t) apo me një pakujdesi gjatë përpunimit redaksional të këtij kreu, kjo çështje vështirë se mund të zgjidhet shterueshëm në kushtet e sotme të disponimit të materialit. Një përqasje e përciptë e kreut të parë të punimit original të Masci-t me gjegjësin e tij në ribotimin frengjisht prej Malte-Brun-it mundëson gjithsesi që të izolohet vendi ku është përfshuar ky gabim. Është fjalë për riorganizimin e shënimit Nr. 3 (f. 5 te Masci, përkatesisht f. 148 te Malte-Brun-i), ku mënjanohet thuaçse i gjithë shënimë origjinal¹⁷.

Pa dashur të ndalemi më gjatë në këtë problem, të cilin e kemi trajtuar gjetkë, mund të përfundojmë shkurt se si mbledhja e 102 njësive leksikore ashtu edhe përqasjet e tyre të para me disa gjuhë i takojnë Masci-t. Në shënimin e sipërpërmendur (shih shën. nr. 17) ai ka marrë nga një pistullë e Leibniz-it 62 fjalë

Geschichte der idg. Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch Bopp.II, Die Erforschung der idg. Sprachen, Bl. III, Straßburg 1917, f. 127v.; M. Camaj: Albanische Wortbildung, Wiesbaden 1966, f. 9v. etj.

¹⁶ Shih B.Demiraj, *art. cit.*, ku kumtohet edhe literatura shkencore përkatëse.

¹⁷ Shënim i Masci-t: “Leibnitz Epist. Ad Andream Acoluthum. 10. Octob. 1695 Collect.tom6 p. 2, pag. 138. ci reca moltissime parole di quell' idioma, delle quali io noterò alcune per far vederela differenza dall'Albanese...” (radhitën gjithsej 62 fjalë të gjeorgjishtes, të cilat krasohen gjegjëset kuptimore shqipe – shih II/1/a), zëvendësitet në ribotimin e Malte-Brun-it: me vërejtjen: “...(On trouvera les principaux mots de la langue albanaise, donnés par Leibnitz, réunis à la fin de ce premier chapitre. Nous supprimons ...”.

të gjeorgjishtes dhe i ka krahasuar ato më pas me gjegjëset shqipe, për të treguar se sa të ndryshme janë këto dy gjuhë nga njëra-tjetra. Lidhur me 41 njësítë e tjera, të menduara si huazime galike, Masci nuk i referohet asnë burimi letrar apo bibliografik.

3. ... në veprën e Masci-t

Këto fakte shtrojnë tashmë rishtas për diskutim burimin dhe karakterin dialektor të materialit leksikor që shfrytëzon Masci në vepër. Në një grupim paraprak të këtij materiali (shih II/1), rezulton sa vijon:

Masci (II/1/d) ka shfrytëzuar (dhe interpretuar) nga materiali shqip i letrave të Leibniz-it një numër të vogël njësish leksikore, të cilat – siç dihet - burojnë nga veprat e autorëve të vjetër të Veriut (P. Budi dhe F. Bardhi). Shembujt e sjellë në shqyrtim, pavarësisht karakteri i tyre dialektor (gjegjë), Masci në fillim i paraqet grafikisht sipas burimit origjinari, e më pas i përshtat pjesërisht në variantin dialektor përkatës të të folmeve arbëresh, khs.:

Leibniz	Masci
«Attī-yne» ~ /ati ynə/	«Attī inn» ~ /ati in/
«seeb» ~ /ðe:t/ (lokativ)	«deeb» ~ /ðe:/
«e-na-ndeye-ne» ~ /e na ndəje ne/	«e na ndeye-ne» ~ /e na ndəje ne/
«nde-te-kech» ~ /ndə tə kec/	«nde te kech» ~ /ndə tə kec/

Ato njësi të grupuara në paragrafët II/1/c;e, për të cilat Masci nuk jep të dhëna të plota bibliografiqe, mund të shqyrtohen si njësi leksikore me karakter dialektor tosk dhe arbëresh, p.sh.:

«l-Speiti» ~ /i ſpejtɪ/ “i shpejti” (mbiemër i substantivizuar),
«bora» ~ /bora/ “bora”
«bugliaar» ~ /bułla:r/ “bujar; gentliuomo”
«cetta» ~ /tʃeta/ ~ /et/ ~ /ə/ “gjini; çetë, grup i armatosur”
«masi» ~ (?) /mazi/ ~ g. măž-i, t. mëž-i “polledro” ¹⁸ .

Mënjanimi i Letrave të Shqiptarëve të Leibniz-it si burim i mundshëm i dy grupimeve leksikore kryesore (II/1a-b) e rrisin padyshim edhe mëdyshjen mbi karakterin dialektor gegjë qoftë edhe për një pjese të tyre. Nga ana tjetër, mungesa e referencave bibliografiqe në vepër nxit mendimin, që burimi i materialit leksikor do këkuar në të folmet e ngulimeve arbëreshe të Italisë, e pse jo në vetë të folmen e autorit arbërishtfolës: Santa Sofia d'Epiro¹⁹.

Po të ndjekim nga afër këtë rrugëzgjidhje, do të vërejmë menjëherë se kriteret gjuhësore të klasifikimit dialektor, që parashtruam me sipër (III/1a-c), jo vetëm që nuk i bien ndesh, por e tumirin, madje ndonjë syresh e përforcon bindshëm opcionin, sipas të cilët burimet e korpusit leksikor kryesor në vepër duhen kërkuar pikërisht në arealin e ngushtë dialektor, të ashtuquajtur *Arbresh* (Hamp), apo në atë më të zgjeruar, përkatësisht *Cosentino* (Altimari), në të cilët bën pjesë edhe fshati i lindjes së Masci-t²⁰. Kështu p.sh.:

¹⁸ Krejt e paqartë mbetet njësia doonaar [lo:na:a:r] “korrik”.

¹⁹ Për jetën e Masci-t shih A. Marchiano në botimin e tretë të veprës së Masci-it: *Discorso del consigliere di stato Angelo Masci sull' origine, i costumi e lo stato attuale degli Albanesi del regno di Napoli*, (Ristampato per cura di Francesco Masci) Napoli 1847, f. 9-14.

²⁰ Autori i këtyre radhëve nuk është në dijeni të ndonjë studimi të veçantë dialektor mbi të folmen e Santa Sofia d'Epiro. Karakteristikat e kësaj të folmeje janë nxjerrë nga dy studime

- Forma *ulk* është karakteristike për këtë zonë (khs. Hamp 1993 Glossario: *ulk*; Altimari 1994 241; Macch. /*ulk*/), duke u dalluar në këtë mënyrë nga ndonjë zonë tjeter e provinzhës së Cosenza-s (khs. Giordano 520: Falc. *ujk*)²¹.
- Varianti i zgjeruar *żjarm* nuk është i panjohur në arbërishten e Italisë (khs. Giordano 573: *żjarm*, *żjarm*).
- Bjerrja e fundores /-ə/ tek emrat e pashquar është dukuri e zakonshme për zonën dialektore në shqyrtim, khs. *buk* “bukë”, *nat* “natë”, *vap* etj. (Hamp 1993 Glossario; Altimari 1994 247).
- Format leksikore ‘*ambràmma*, ‘*àmm* etj. mund të interpretohen bindshëm si variante të zonës dialektore në shqyrtim. Këtë e kushtëzon, siç do ta shohim më poshtë, leximi korrekt grafisë ‘*à*’ të cilën e ndeshim vetëm në sistemin grafik të Masci-it.

Pra, një zgjidhje bindëse e problemit kërkon studimin sistematik të korpusit leksikor për çdo njësi në veçanti, në bashkëvajtje ky me njohjen e patëmetë të sistemit grafik dhe me tiparet dialektore të gjuhës së Masci-t.

IV. Sistemi grafik i Masci-t dhe tiparet themelore të gjuhës tij

1. Sistemi grafik: risi apo trashëgim?

Raporti “*risi ~ trashëgim*” në sistemin grafik të Masci-t vështirë se mund të sqarohet shterueshëm, përderisa materiali gjuhësor shqip që ai përdor është i kufizuar, e përmë tepër, - siç u përmend edhe më lart -, në vepër nuk ndeshim referanca mbi vepra dhe autorë bashkëkohës a të mëparshëm, të cilët kanë lëvruar dhe/ose studiuar arbërishten²². Gjithsesi të bien në sy nga njëra anë ndikimi i shkrimit latino-italian, që shfaqet tek të gjithë autorët e tjerë para tij (p.sh.: ‘gl’, ‘gli’ për [ʌ], ‘c’, ‘ch’ për [k], përdorimi i bashkëtingëlloreve dyshe etj.) e nga ana tjetër përdorimi i shenjës së veçantë konvencionale ‘*à*’ përfonemën /ə/ (ndoshta edhe ‘*th*’ për [θ])²³). Ashtu si te shkrimitarë e dijetarë të tjerë arbëreshe e shqiptarë para tij, edhe te Masci vërejmë prirjen drejt një shkrimi fonetik, vlerat e përafërtë të të cilit i kemi përbledhur e sistematizuar në tabelën e mëposhtme, sigurisht duke u mbështetur edhe në studimet e sotme dialektore përfundimisht folmet e arealit *Arbresh* (shih shën. 20):

të shkëlqyera përfundimisht e dy fshatrave të së njëjtës zonë dialektore: E.Hamp: *Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo*, Rende 1993; dhe F. Altimari: *La parlata di Macchia Albanese: appunti fonologici*, në: *I dialetti italo-albanesi* (botues: F.Altimari – L.M.Savoia), Roma 1994, f. 239- 259).

²¹ Në arealin dialektor gegë forma arkaikë *ulk* ndeshet rregullisht vetëm në mesharin e Buzukut, të cilin si Leibniz-i ashtu edhe Masci me siguri që nuk e kanë njohur. Te fjalori i Bardhit gjejmë formën dhuc [huk] “lupus” pranë ndërtimit misional *vlcogna* [ulkoja] “lupa, la lupa”.

²² Në kreun e fundit të veprës Masci përmend kolegjin arbëresh në S.Benedetto Ulano, dhe dy nga rektorët e tij: F. Bugliari (f. 83) e D. Belluscio (f. 87).

²³ Kjo grafi përdoret gjithsesi edhe nga L.Matrënga (shih Sh. Demiraj: *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, - Dispencë - Tiranë 1962, f. 36); dhe N.Chetta (shih. Mandala: *art. cit.*, f. 142).

Sistemi grafik i Angelo Masci-t²⁴

Vlera fonemike dhe fonetike	Shenjat grafike te Masci	Shembuj te Masci	Gjegjëset në shqipen standarde
/a/ [a]	⟨a⟩	⟨att⟩	atë “baba”
	⟨a:⟩	⟨aa⟩	shan
/b/ [b]	⟨b⟩	⟨ball⟩	ballë
	⟨bb⟩	⟨rrabb⟩	kërrabë
/ts/ [ts]
/tʃ/ [tʃ]	⟨c⟩	⟨cette⟩ ⟨cetta⟩	cet/ ē-a
	⟨cc⟩	⟨macce⟩	mace, dial. tosk. maçe
/d/ [d]	⟨d⟩	⟨diers⟩	djersë
/ð/ [ð]	⟨ð⟩	⟨dee⟩	dhe “tokë”
	⟨dd⟩	⟨rodd⟩	rrođhi (aor. 3. nj. i rrjedh)
/e/ [e]	⟨e⟩	⟨bres⟩	brez
	⟨e:⟩	⟨deer⟩	derë
/ə/ [ə]	⟨â⟩	⟨embrâma⟩	mbrëmja
	⟨ââ⟩	⟨mâânc “pyll”⟩	mëngë (lumi, pylli)
	⟨e⟩	⟨pestiim⟩	shpeitim pështymë
	⟨ee⟩	⟨deemb⟩	dhëmb
/f/ [f]	⟨f⟩	⟨fluttur⟩	flutur
/g/ [g]	⟨g⟩	⟨gomar⟩	gomar
	⟨gh⟩	⟨ghnet [gnet]⟩	“gju”
/ħ/ [ħ]	⟨ħi⟩	⟨ħiāmb⟩	ħiemb
/ħ/ [ħ]	⟨ħ⟩	⟨ħecur⟩	bekur
		⟨ħii⟩	hi
	⟨g⟩	⟨gund⟩	hundë
		⟨gapp⟩	ħap (għejn)
/ç/ [ç]	⟨k(k)⟩	⟨rakk “kodér, mal”⟩	rrab
/i/ [i]	∅	⟨crip⟩	kripë
	⟨i:⟩	⟨ħii⟩	hi
/j/ [j]	∅	⟨jù⟩	ju
	⟨ħi⟩	⟨ugħiħ (?) [uj]⟩	uji
	∅	⟨bieen⟩	blen
/k/ [k]	⟨c⟩	⟨cau⟩	ka,-u
		⟨cord⟩	kordbë
		⟨crimb⟩	krimb
	⟨c(h)⟩	⟨buc⟩	bukë
		⟨grich⟩	grykë
		⟨miechr⟩	mjekér
	⟨cu⟩	⟨cuol⟩	kollë
/l/ [l]	∅	⟨desc⟩	lesh
	⟨lb⟩	⟨ball⟩	ballë

²⁴ Një përpjekje të parë për paraqitjen e sistemit grafik të Masci-t e ndeshim te T.Osmani: *Udhë e shkronjave shqipe*, Shkodër 1999. Në të hasim një sërë gabimesh, ndër të tjera: ⟨c(c)⟩ për /ts/, është për /y/. Autori përsiat praninë e tri lëngëtoreve të ndryshme, ndërsa grafinë â nuk e pasqyron fare, duke lënë bosh edhe vendin e zanores qëndrore /ə/. Po ashtu nuk shqyrtohen fonemat e veçanta /ħ/ (⟨g, gh⟩) dhe /ç/ (⟨k(k)⟩).

/λ/	[λ]	⟨gli⟩	⟨gliee⟩	lë
		⟨gl(l)⟩	⟨mieglb	mjel
			⟨daglb	dal
			⟨puugb	pule
/m/	[m]	⟨m⟩	⟨matt	masë
		⟨mm⟩	⟨ghiumm⟩	gjumë
/n/	[n]	⟨n⟩	⟨nat	natë
/ɲ/	[ɲ]	⟨gn⟩	⟨neriij	njeri
/o/	[o]	⟨o⟩	⟨mob	mot
	[ɔ:]	⟨oo⟩	doonaar (?)	
/p/	[p]	⟨p⟩	⟨pemmm	pemë
		⟨pp⟩	⟨vapp⟩	vapë
/c/	[c]	⟨ch(i)⟩	⟨chien⟩	gen
			⟨gleich⟩	lege (sh.)
/r/	[r]	⟨r⟩	⟨peerndiij	perëndi
/R/	[R]	⟨rr⟩	⟨varri	varr,-i
/s/	[s]	⟨s⟩	⟨sii⟩	sy
			⟨diers⟩	djersë
			⟨bres⟩ [bres]	brez
/ʃ/	[ʃ]	⟨sci⟩	⟨sciaan⟩	shan
		⟨s(c)⟩	⟨sctrab	shtrat
			⟨spiirt	shpirt
/t/	[t]	⟨t⟩	⟨mut	mut
		⟨tb⟩	⟨fluttur	flutur
/θ/	[θ]	⟨th⟩	⟨thron	fron
			⟨bath⟩	bathë
			⟨math⟩ [math]	(i) madh
/u/	[u]	⟨u⟩	⟨uthub	uthull
	[u:]	⟨uu⟩	⟨druu⟩	dru
/v/	[v]	⟨v⟩	⟨vapp⟩	vapë
/dz/	[dz]
/dʒ/	[dʒ]
/z/	[z]	⟨z⟩	⟨ziarm⟩	zjarr
			⟨ghiiz⟩	gjizë
/ʒ/	[ʒ]

2. Disa vërejtje lidhur me sistemin grafik

- Numri i kufizuar i njësive leksikore që merren në analizë kushtëzon deri diku mospasqyrimin grafik të të gjithë sistemit fonetik. Kështu, mungojnë gjegjëse grafike të sigurta për fonemat /dz/, /dʒ/, /ʒ/. E paqartë mbetet grafia ‘tic’ tek ‘ticlisce’ “solleticare” (shih V/2/nr. 103).
- Në pasqyrimin grafik të tingujve (= fonemave) [t], [ð], [g], [f], [v], [k], [l], [λ], [ɲ], [c], [r], [R], [s], [ʃ], në dyfishimin e bashkëtingëlloreve si edhe në dyfishimin e zanoreve (për të pasqyruar gjatësinë e tyre), vërejmë pak a shumë bashkëpërkime me traditën latino-italianizuese në letërsinë arbëreshe dhe në atë shqiptare (katolike) në përgjithësi.
- Fonema [c] pasqyrohet me sa duket me ‘k(k)’, megjithëse del vetëm në një shembull: ‘rakk’ “monte” (khs. Vacc. *rax,-i* “collina”; shih Hamp, *vep. cit.*, Glossario).

- d) Problem mbetet grafia *ughis* (?) [uj] “ujë” (khs. Vacc. *uy* “aqua”; shih Hamp, *vep. cit.*, Glossario).
- e) Grafia «th» pér [θ], tē cilën përdori dikur Matranga e më pas në mënyrë sporadike edhe Figlia (shih shën 23), mund tē jetë ndoshta një gjetje e pavarur Masci-t, përkatësisht një zgjidhje teknike e botuesit.

I njëti supozim vlen edhe pér grafinë e veçantë â pér /ə/. Lidhur me inventarin e kësaj grafie bie gjithsesi në sy përdorimi i saj thuajse vetëm në rrokje të theksuar (para një tingulli hundor), duke iu kundërvënë kështu grafisë «x» thuajse vetëm në rrokje të patheksuar, khs.: *għiāmb* “spina”, *mâanc* “selva” etj. pranë «cette» “çetë”, *pestiūm* “saliva” etj. Nga kjo rregullsi bëjnë përfashtim vetëm dy njësi: *deemb* “dente” dhe â në rrokjen e dytë âmâr “nome”.

3. Dukuri fonologjike-dialektore të gjuhës së Masci-t

Përqaṣja e karakteristikave gjuhësore që mund tē hetohen në strukturat fonologjike të materialit leksikor shqip në veprën e Masci-t me tiparet dialektore që njihen tashmë pér arealin *Arbresh*, mbështet përfundimisht opcionin, sipas tē cilit ky material leksikor, në pjesën e tij dërmuese i referohet fondit dialektor tē së folmes së vendlindjes së autorit. Gjatë analizës së korpusit leksikor dallohen bindshëm:

- a) Gjatësia (pozicionale):
- Zanoret e theksuara në rrokje tē mbyllur nga një sonante likuide janë tē gjata, khs.: *deer* [de:r] “porta”, *għeer* [ye:r] “ora”, *puugħ* [pu:l] “gallina”²⁵, nē dallim nga *pemm* [pem] “pomo”, *chien* [cen] “cane”.
 - Tē tilla jané edhe zanoret e theksuara në rrokje tē mbyllur nga një obstruent i zëshëm: *għiżiż* [ji:z] “ricotta”.
 - Po ashtu edhe zanoret e theksuara fundore nē rrokje tē hapur, khs.: *għiġi* [yi:] “cenere”, *diżiż* [ði:] “capra”, *druu* [dru:] “legno” etj.
 - Zanoret e patheksuara realizohen kurdoherë tē shkurtra: *għecur* [yekur] “ferro”, *uthub* [uθul] “aceto”²⁶, *mot* [mot] “tempo”, *għiach* [jak] “sangue”, *ex* [e] ”ed”, *te* [tə] (articolo: f. 23) etj.
- b) Në pozicion (burimisht) fundor bashkëtingëlloret e zëshme bëhen tē shurdhëta nē rast se nuk paraprihen nga një bashkëtingëllore hundore, khs.: *ħbres* [bres] „petto“; nē dallim nga *għiżiż* [ji:z] (* /jɪzə/) *crimb* [krimb] „verme“.
- c) Proceset e asimilimit tē grupeve /gl/, /kl/ dhe /bl/²⁷ nē /ʃ/, /c/ dhe /bj/, khs.: *għiāmb* [fømb] „spina“ (* /gləmb/, *ċhiuṁscib* [cumʃt] „latte“ (* /kluməʃt/), *bieen* [bié:n] „compra“ (* /blen/)
- d) Forma âmâr [əmər] me nistoren e theksuar /ə/ (në vend tē /e-/), khs. Macc. /əmer/ (Altimari: *art. cit.* 242; Hamp: *vep. cit.* Glossario: *əmer*)

²⁵ Përfashtim bëjnë *għomar*, *bieen*.

²⁶ E paqtar *Peerndi*, ndoshta gabim shtypi pér *perendii.

²⁷ Shih më hollësish pér këtë dukuri nē tē folmet e ndryshme arbëreshe, F. Solano: *I dialetti albanesi dell'Italia meridionale. I Appunti per una classificazione*, nē: *Quaderni di Zjarri*, Castrovilliari 1979, f. 6vv. *Quaderni di Zjarri* Pér /pj/ (* /pl/) s'kemi dëshmi te Masci. Gjithsesi kérkon shpjegim regjistrimi i njësisé *fluttur* “piuma”, ku ruhet grupi /fl/.

V. Fondi leksikor shqip në veprën e Masci-t

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar i gjithë fondi leksikor shqip që ka shfrytëzuar Masci në veprën e tij. Numërimi (kolona e parë) dhe regjistrimi (kolona e dytë) ndjekin radhën alfabetike. Në kolonën e dytë është bërë përpjekje përfshirë të dhënë me afërsi edhe strukturën fonetike të njësive leksikore përkatëse, duke i shoqëruar ato me kuptimet në italisht, ashtu siç i ka përkthyer Masci. Lidhur me paraqitjen grafike kemi shmangje në disa raste, kur mendohet se kemi të bëjmë me gabime shtypi. Këto raste (ose ndonjë rast të ngjashëm) kanë në anë shenjën e asteriksit, i cili tregon se përfshirë janë ndërmarrë shpjegimet përkatëse në listën e vërejtjeve që i është pasvendosur tabelës sipas numrit të radhës përkatëse.

Që studiuvesi dhe lexuesi duhet të mbajë parasysh se gjatë shkrimit ose shtypit të veprës mund të janë përfshirë edhe gabime, këtë e dëshmon qartë kolona e tretë, ku janë shënuar ato njësi që ndeshen në ribotimin (= ripunimin) e veprës në frëngjisht nga Malte-Brun-i. Rastet, kur shembujt ose përkthimi i tyre është i patëmetë, janë parashikuar me shkurtimin *id(em)*. Përndryshtë është regjistruar paraqitja grafike përkatësisht përkthimi i gabuar, ashtu siç dalin në ribotimin e veprës. Përfshirë janë leksikore, të cilat Malte-Brun-i nuk i ka përcjellë në rubrikën e veçantë “Vocabulaire albanais” janë përdorur pikat e vazhdueshme.

Ndarja e dytë “Zgjidhjet etimologjike” përbëhet gjithashtu nga tri kolona. Në kolonën e parë janë plotësuar kutitë e radhës vetëm përfshirë ato njësi, përfshirë ato që nuk janë trajtuar në pikëpamje etimologjike janë parashikuar gjithashtu me pikat e vazhdueshme. Në kolonën e dytë “Malte-Brun” janë regjistruar (sipas origjinalit) njësitë kryesore, me të cilat autorë sheston lidhjet etimologjike të afërisë, gjithsej përfshirë 89 njësi. Kutitë e radhëve të këtyre njësive shoqërohen në kolonën e fundit me simbolet “+/-” (pranë “+/-”) dhe “-” përfshirë ato që nuk janë marrë parasysh në studimet e mëvonshme etimologjike në fushë të shqipes. Në disa raste kemi përdorur simbolin (-) përfshirë ato që nuk janë marrë parasysh në studimet e mëvonshme etimologjike në fushë të shqipes. Në fakt burimi e gjegjësës së shqipes.

Glosar i fjalëve shqipe në veprën e Masci-t

Njësítë leksikore në paraqitjen e tyre grafike				Zgjidhjet etimologjike		
Nr.	Shq. let.	Masci	Malte-Brun	Masci	Malte-Brun	+/-
1	asht	asctb [aſt] „osso“	asetb	...	gr. aseptos	-
2	atë	attb [at] „padre“	id.	...	lat. at-avus, ata	+
3	ballë	ballb [bal] „fronte“	þald	bald	...	
4	bathë	bathb [baθ], „fave“	id.	beans	...	
5	bijë	þiglia ^v [biłja] „figlia“	id.	...	lat. filia	+/-
6	blej	þbieen ^v [bie:n] „compra“	id.	buy	angl. buy	-
7	borë	þora ^v [bora] „neve“	id.	...	gr. bóreas “vent du nord”	+
8		sbih Nr. 4kopscb	þostani	...	mot turc	

9	bretkocë	«bretkos» [bretkos] „rana“	id.	...	gr. brekekex “cri des grenouilles”	-
10	brekë	«brech» [brek] „calzoni“	id.	broches	angl. breeches, kelt. is. brok	-
11	brez	«bres» [bres] „petto“	id.	brest	angl. breast	-
12	bukë	«buc» [buk] „pane“	id.	...	gjerm. backen “cuire le pain”	-
13	bujar	«bugliaar» [buł:a:r] “gentiluomo”	id.	
14	çetë	«cetta» [tʃeta] “tribù” f. 49	id.	...	gr. syssitia “confrérie”	-
15	derë	«deer» [de:r] „porta“	id.	door	pers. dar, gr. thyra	+
16	dal	«daglb» [dalɔ] „tempreggiare”	id.	dally	dan. dangle “marcher”	-
17	det	«deet» [de:t] „mare“	id.	...	gr. deein “lier, réunir”	-
18	diell	«diel» [diel] „sole“	id.	...	lat. dies “jour”	+/-
19	djersë	«diers» [diers] „sudore“	id	...	gr. diygros “humide »	-
20	drítë	«drít» [drít] „luce“	id.	...	it. d(i)ritto “droit”	-
21	dru	«druu» [dru:] „legno“	«drun»	...	gr. drys “chêne”	+
22	dhe,-u	«dee» [ðe:] „terra“	id	...	gr. dera “le dos (montagne)”	-
23	dhëmb	«deemb» [ðə:mb]* „denti”	id.	teeth	lat. dens	-
24	dhi,-a	«diiv» [ði:] „capra“	id.	...	gr. diein “crandre, courir”	-
25	e	«e» [e] “ed” f. 23	«e»	...	Ital. e(d)	+
26	emér	«âmâr» [əmər], „nome“	«amâr»	...	arm. anun	+
27	ëmë	«âmm» [əm] „madre“	«amm»	...	dan. amme	+
28	flutur	«fluttur» [fłutur]* „piuma“	id.	feuther	gjerm. Flittich	-
29		«gapp»* [yap] „sbadigliare“	id. “bâiller”	gape	sued. gapa	-
30	gomar	«gomar» [gomar] „asino“	id.	...	gr. gomos „charge“	+/-
31	grurë	«gruur» [gru:r] “grano”	id.	...	fr. gruau,	-
32	grykë	«grich» [grik] „bocca“	id.	...	gr. gryzein “ouvrir la bouche”	-
33	gjak	«ghiach» [ʃak] „sangue“	id.	...	gjerm. Göscht	-
34	gjarpér	«ghiarpr» [ʃarpr] „serpente”	«ghiarns»	...	gr. gyrios “se roulant”	-
35	gjëmb	«ghiâmb» [ʃəmb] „spina“	«ghiamb»	
36	gjizë	«ghiiz» [ʃi:z] „ricotta“	id.	cheese	angl. cheese, lat. caseus	-
37	gjumë	«ghiumm» [ʃum] „sonno“	«ghium»	...	gr. koimómai “je repouse”	-
38	hap	«appn» [apn] „aprì“	id.	open	angl. open	+/-
39	hekur	«hecur» [yekur] „ferro“	«heur»	gjerm. Guhr “eau cimentatoire ferrugineuse”	-

40	herë	gheer [yer] „hora“	id.	...	lat. hora	(-)
41	hi	ghii [yi:] „cenere“	id.	...	gr. gê “terre”	-
42	hundë	gund [yund]* „naso, cane di caccia“	id.	hund	gjerm. Hund “chien”	-
43	Ju	ju [ju] „voi“	ju	you	angl. You	+
44	ka-u	caw [kau] „bove“	id.		gjerm. Kuh “vache”	-
45	kalorës	caagliuar [kałuar] „cavaliere“	id.	...	it. cavaliere	(-)
46	keq	kech [kec] “male”	kech	...	gr. kakon	(-)
47	kollë	coll, cuol [kol]* „tosse“	cuol	cough	angl. cold “fièvre”	-
48	kopsht	copsct* [kopst] „orto“	
49	kordhë	cord [korð] „spada“	id.	sword	dan. korde	-
50	krimb	crimb [krimb] „verme“	id.	...	dan. kryb “insectes”	-
51	kripë	crip [krip] „sale“	id.	
52	krye	crie [kríe] „capo“	id. „chef“	...	gr. kreein „mbretëroj“	+
53	krrabë	crrabb [krrab] „granchio“	crrab	crab	angl. crab “crabe”	-
54	leqe	gliech [łec]* „gamba“	id	leq	angl. leg “jambe”	-
55	lesh	desc* [leʃ] „lana“	
56	lë	gliee [łe:]* „lasciare“	...	leave	...	
57		doonaar [lo:ná:r] “Luglio” f. 22	id.	
58	loz	gliosn [łosn] „gioca“	id.	...	isl. losa “tirer au sort”	-
59	luftë	gliufþ [łuft] „guerra“	id.	
60	luftëtar	gliuftaar [łufta:r]	gliuftar	lofty	angl. lofty	-
61	mace	macce [matse]* „gatta“	id.	gjerm. Mautzen	-
62	(i) madh	math [maθ] „grande“	...	made	...	
63	mallkuar	malcuar [malkuar]	id.		lat. maledicere	(-)
64	masë	matt [mat] „misura“	id.	mate	dan. maade “mesure”	
65	mëngë	mâânc* [mə:nk]* „selva“	id.	...	gr. monê	-
66	mëz	masi “polledro” f. 79	
67	mbrëmje	mbrâmma [mbrëma]* “sera”	mbrâmma	
68	miell	mieb [miel] „farina“	id.	meal	gjerm. Mehl	+
69	mjekër	miechr [mjekør] „barba“	id.		gr. mystax	-
70	mjel	rieglb [mjeł]* „mungere“	riegl	milk	sued. mioelka	+
71	mot	mot [mot] „tempo“	id.	...	lat. motus « mouvement »	+
72	mut	mut [mut] „fango“	id.	mud	dan. mudder “fange”	-
73	na	na [na] “ci” f. 23	na		lat. nos	+
74	ne	ne [ne] f. 23	
75	natë	nab [nat] „notte“	id.		dan./sued. nat	+
76	ndë	nde [ndø] “in” f. 23	nde	...	dan. udi	-

77	(na) ndje	«ndeyex [ndəjə] „perdona“ f. 23	
78	njeri	«gneriū [nəri:] „uomo“	gnériū		khs. gr. aner	+
79		«ghnet [gnet]* „osso della gamba, ginocchio“,	id.	krees	angl. knee “genou”	-
80	pemē	«pemm [pem] „pomo“	«pemne	...	lat. pomum	(-)
81	perëndi	«perendiū [perendi:]*	«perndiū	...	sll. Peroun	+/-
82	pulē	«puugb [pu:λ] „gallina“	«pungb	...	lat. pullus	(-)
83	qen	«chien» [cen] „cane“	id.	...	gr. Kyon	-
84	qiell	«chielb [ciel] „cielo“	id.	
85	qumësht	«chiumscb [cumʃt] „latte“	«chiumse t	...	gr. cheuma “fluide”	-
86	rak ?	«rakkø [raq]* „monte“	id.	fr. roc	-
87	rrođhi	«rođd [Rođ] „correre“	id.	rond	angl. rod (ride)	-
88	rjep	«rip» [rip] „scorticare“	...	rip	...	
89		«rons» [rons]* „bagno“	«rous»	...	gr. roos	-
90	ruaj	«ruagn» [ruaj] „vedere“	id.	...	sued. roena “decouvrir”	-
91		«slibb» [slib]* „sono profondo“	id.	sleep	angl. sleep	(?)
92	sy	«sib» [si:] „occhi“	id.	see	angl. see “voir”	-
93	shan	«sciaan» [ʃa:n] „vergogna“	id.	shame	gjerm. Scham	-
94	shapkë	«sciapc» [ʃapk] „cappello“	...	sciacpc	...	
95	i shpejtë	«speiti» [ʃpejt] „veloce“ f. 22	id.	
96	shpëtim peshtymë	«pestiim» [pəsti:m] „saliva“ shpëtim	...	spittle	...	
97	shpirt	«spiirt» [ʃpi:rt] „anima“	id.	...	lat. spiritus	(-)
98	shtëpi	«spii» [ʃpi:] „casa“	id		gr.-ion. spíos “antre”	-
99	shtie	«sctiir» [ʃti:r] „gettare“	«setiir»	stir	gr. seein «remuer»	-
100	shtrat	«sctrab» [ʃtrat] „letto“	«setrab»	gr. tetrastylos	-
101	tallur	«talluun» [talu:r]* „piatto“	«tallur»	Teller	gjerm. Teller	(-)
102	të	«te» [te] (articolo) f. 23	«te» „le“	...	angl. the	+
103		«ticlisce» [..]* „sollecicare“	“sollecita re”	tickle	...	
104	fron	«thron» [θron] „sedia“	id	lose	gr. thronos “siège”	(-)
105		toch [tok]* „zona virginale“	...	toque	...	
106	ujë	«ughb» [uj]* „acqua“	id.	...	gr. hygron “humidité, eau”	-
107	ujk	«ulc» [ulc] „lupo“	
108	ungj	«ungb» [ungl]* „zio“	id.	onkle	lat. avunculus	(-)
109	uri, dial. u	«uu» [u:]* „fame“	«un»	Hunge r	gjerm. Hunger	-
110	uthull	«uthub» [uθul] „aceto“	id.	...	lat. vapor	
111	vapë	«vapp» [vap] „caldo“	id.	...	“chaleur”	(-)

112	varr	«varri» [vaR-i] „sepolcro	...	qury	...	
113	yll	«ilb» [i:l] „stella“	qilb	...	dan. ild “feu”	-
114	ynë	«inn» [in] „nostro“ f. 23	«inu»	
115	zjarr	«ziarm» [ziárm] „fuoco“	«ziarm»	...	gr. zein „bouillir“	-

2. Vërejtje lidhur me njësi të caktuara në glosar.

- Nr. 29: «gap» [yap] - Mbetet për t'u sqaruar regjistrimi i strukturës fonetike të kësaj fjale pranë variantes leksikore «appn» “hap; aprire”. Forma «appn» i shkon gjithsesi për shtat supozimit të Masci-t, sipas të cilit kjo fjale është huazim galik (: *open* angl. “hap”) në shqipe.
- Nr. 42: «gund» - Kuptimi i dytë “cane di caccia” është shtuar ndofta nën ndikimin e Leibniz-it (shih shën. 7), i cili krahason etimologjikisht shq. *bundë* meme gjerm. *Hund*, „qen“.
- Nr. 47: «coll», «cuol» [kol] - Mbetet për t'u sqaruar, nëse pasiguria në paraqitjen grafike lidhet ndikimin e ortografisë së italishtes apo me mënyrën e shqiptimit të fjalës në të folmen e Masci-t.
- Nr. 48: «copscb» [kop t]; shkruar gabim «copset», khs. Giordano 198: *köpsh-t-i*.
- Nr. 54: «gleich» [lec] - Ndoshfa një formë shumësi e *lak* m. “tendini; calgano; curva del ginocchio” me bjerrje të mbaresës së shumësit {-e} (khs. Giordano 225: *läge-t*). Kuptimi “gamba” është sajuar me sa duket nga Masci për të bërë më të qartë huazimin e supozuar po prej tij nga gal. *leg* (dmth. angl. *leg*).
- Nr. 55: «desc» [leʃ] “lana”; shkruar gabim dese.
- Nr. 61: «macce» - Do lexuar pas gjithë gjasash si [matʃe], khs. Giordano 249: (Fra.) *mase*.
- Nr. 65: «mâanc» [mə(:)nk]; shkruar gabim «mââne», khs. Giordano 275: (S.M.) *mëng/ë,-a* “bosco”.
- Nr. 67: «embrâmma» - Grafia në fund të fjalës nuk lexohet qartë. Pas gjithë gjasash do jetë korrigjuar nga autori në -a. Kështu që regjistrimi i fjalës rezulton të jetë në trajtën e shquar (rasa emërore) «embrâmma» [mbrəma], khs. Nr. 5: «biglia» [biłा]; shih edhe Giordano 265. *mbrëm/ë,-a* f. “mbrëmje”
- Nr. 79: «ghnet» [gnét]; khs. Giordano 129: (Frash.) *gènet* “stinko, femore, ginocchio”.
- Nr. 81: shkruar *peerndii*; shih shën 26.
- Nr. 89: «rons» (?) - Pas gjithë gjasash një variante e *ronx-i* m. (Fra.) “stagno, pozzanghera, laghetto” (khs. Giordano FAI 411). Forcimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës është një tipar i veçantë i glossarit (= variantit dialektor të) Masci-it. Në gjuhën e folur ndodh dendur shndërrimi i tingullit afrikat [ts] në [s] në pozicion fundor; khs. «bretkos» “rana” (Masci 6) me *bretkoc,-i* m. pranë *bretkos/ë-a* f. (Giordano 38).
- Nr. 91: «slubb» [slib]; khs. Giordano 442: (Fra.) *slilib/ë,-a* f. “letargo, sonno profondo”.
- Nr. 96: «pestüm» [peʃtím] - Formim deverbativ prej *pështonj* “salvare” si variante dytësore me metatezë e *shpëtonj* (khs. Giordano 372, 476)
- Nr. 101: «talluur „piatto“; fiuk është e regjistruar në fjalorin e Giordanos.
- Nr. 103: «ticlissee „solleticare“ - Kuptuar nga Malte-Brun si “sollecitare; zgjidh”.